



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM
Dt. 20.09.2010, Nr. 132-6135



Në bazë të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunitet e Republikës së Kosovës të nenit 5 pika (i), Drejtoria e Drejtorisë Komunitare të Arsimit nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Drejtoria Komunitare për Arsim në Drenas duke e marrur për bazë mungesat e drejtorëve të institucioneve arsimore, mësimdhënësve, personelit tjetër në procesin edukativ – arsimor dhe stafit të DKA-së, do të aplikoi ndalesa në paga-mëditje si masë disiplinore.

II. Drejtoria Komunitare për Arsim në Drenas nëpërmes këtyre masave disiplinore në ndalesat në paga-mëditje për drejtorët e institucioneve arsimore, mësimdhënësve, personelit tjetër në procesin edukativ – arsimor dhe stafit të DKA-së, synon që procesi edukativ – arsimor dhe procesi i përgjithshëm i zhvillimit të punës në sistemin arsimor të Komunës së Drenasit të zhvillohet në mënyrë sa më efektive.

III. Drejtoria Komunitare për Arsim, do të bëjë ndalesa në paga-mëditje për orë mësimore të humbura, për mungesat në orarin e punës zyrtare, vonesat në kryerjen e punëve të afatizuara dhe punëve të kryera me gabime nëpërmes njoftimeve zyrtare.

Vendimi hynë në fuqi menjëher !

Drenas,
më datë 20.09.2010

Drejtoria e DKA-së
Arsim Mehmeti prof.

